



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr _____ prot

Gramsh, më 03/07/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 03.07.2019

Për: Operatorin Ekonomik- “Meteo” sh.p.k

Adresa: NJA Pishaj, pasuria 6/76, pranë uzinës, Çekin”, Gramsh.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”, me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-13503-03-13-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Kocaj”, me afat 180 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 18/03/ 2019 [Nr. 11]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

* * *

1. **Shoqëria- “Meteo” sh.p.k** me nr.Nipti L26310801C me vlerë të ofertës 39 999 663 (tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, pa TVSH.
2. **BOE - Al-Mexwood” shpk & “Leon Konstruksion “ shpk &”Rafin Company” shpk** me nr.Nipti K36603807B & K71820009I & L52125110A me vlerë të ofertës 30 835 302 (tridhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e pesëmijë e treqind e dy) lekë, pa TVSH
3. **BOE-“Varaku E” shpk & “Zdravo “ shpk** me nr.Nipti J61902509S & J84003411K me vlerë të ofertës 35 739 630 (tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë, pa TVSH
4. **BOE-“Viante Konstruksion” shpk & “Fusha “ shpk & Llazo” shpk** me nr.Nipti K47103804L & J61922018S & K24218401K me vlerë të ofertës 35 391 185,3 (tridhjetë e pesë milionë e treqind e nëntëdhjetë e njëmijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë tre) lekë, pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

- BOE - “Al-Mexwood” shpk & “Leon Konstruksion “ shpk &”Rafin Company” shpk ,për arsyt :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky BOE **nuk** ka dorëzuar ne SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kerkuar ne Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkruara ne DST, konkretisht:

- Ka detyrime te papermbushura ndaj bashkise Gramsh lidhur me garancine e punimeve per Anëtarin e BOE „Shoqëria “Al-Mexwood “ shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion lidhur me mjekun e shoqërisë në kundërshtim me pikën 2.3.6 të Kriterëve të Kualifikimit në të cilën kërkohet se *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*
- BOE nuk plotëson kriterin për një agronom pasi nga verifikimi i listepagesave nuk rezulton të jete i punësuar për një periudhë 8-mujore nga data e zhvillimit të procedurës në kundërshtim me pikën 2.3.7 të Kriterëve të vecanta të Kualifikimit në të cilën është kërkuar *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 1(një) Agronom të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezë pune,Cv si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 8 (tete) muajt e fundit . Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë mjafton që njëri prej anëtarëve të grupit duhet të ketë të punësuar një Agronom”.* Është dorëzuar dokumentacion nga anëtarin “Leon Konstruktion” shpk për një agronom(kontrate,cv,deftesë pjekurie) i cili nuk rezulton në listë pagesat për 8-muajt e fundit.
- BOE nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.18 të Kriterëve të Kualifikimit : *“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Leje Mjedisore Tip C** lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (Kodi III.1.A) ose Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë kontratë për depozitim të mbetjeve jo të rrezikshme me një subjekt të licensuar nga ana e QKL”.* Kontrata e dorëzuar lidhur midis anëtarit “Al-Mexwood “ shpk dhe “Llazo” shpk nuk është noteriale ,si dhe stacioni I transferimit të mbetjeve për të cilën është lidhur kjo kontratë ,është deklaruar në po këtë procedurë dhe për të njëjtin objekt prokurimi nga “Llazo”shpk edhe si pjesë e një bashkimi tjetër operatorësh i cili ka paraqitur ofertë më vete në këtë procedurë.
- Nuk përmbush kriterin për një Makineri për vizimin e rrugëve termoplastike, nga dokumentacioni konstatohet se është dorëzuar nga anëtarin “Al-Mexwood ” shpk faturë tatimore nr.22 datë 03.07.2013(me qera nga “Bajrami N” shpk për një makineri vizimi por pa e specifikuar nëse është termoplastike.
- Anëtarin “Rafin Company” shpk nuk ka dorëzuar listë pagesat e sigurime shoqërore për muajin prill 2019
- BOE-“Varaku E ”shpk & “Zdravo “ shpk,për arsyt :
Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky BOE **nuk** ka dorëzuar në SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të përshkruara në DST,konkretisht:
- Nuk përmbush kriterin për një montator,është dorëzuar nga anëtarin “Zdravo”shpk vetëm një certifikatë trajnimit për montator A.Z , nuk është dorëzuar kontratë pune e vlefshme si dhe dëshmi i kualifikimit të sigurimit teknik.
- Referuar deklaratave të administratorit të subjektit “Zdravo” shpk i cili deklaron se *ing.A.B bashke me të gjithë inxhinieret e kërkuar nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin apo ndonjë subjekt tjetër privat si dhe të gjithë drejtuesit teknike që figurojnë në licensën e shoqërisë nuk janë të dypunësuar”,*nga verifikimet rezulton se ing mjedisit dhe ing.elektrik të cilët janë drejtues teknike të shoqërisë ,figurojnë të jete të punësuar dhe në shtet,dhe drejtuesit teknikë të përfshirë në licensën e shoqërisë janë të punësuar edhe në më shumë se 2 subjekte.
- OE “Varaku E” shpk ka dorëzuar një deklaratë në të cilën deklaron se *“Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jete z.Qirjako Zallota, i cili nuk është i angazhuar në kontrata të*

tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithë kohës që do te kryhen punimet ne object”,ndërkohë nga verifikimet rezulton se figuron të jetë i punësuar edhe ne dy subjekte të tjera ,fakt që tregon se ky drejtues teknik s’mund të jetë i pranishëm gjithë kohës gjatë zbatimi të punimeve në objekt.Po kështu ing.elektrik dhe ing.mjedisit të këtij OE figurojnë të jenë punësuar dhe në shtet.

- Nuk permbush kriterin për një Makineri per vizimin e rrugeve termoplastike, nga dokumentacioni konstatohet se është dorëzuar nga anëtari ”Zdravo” shpk një deklaratë doganore R101194 datë 29.09.2018 për një makineri vijëzimi si dhe nga ”Varaku-E” shpk deklaratë doganore nr. R31559 datë 30.04.2009 ,por pa e specifikuar nëse është termoplastike në të dy rastet ,sic kërkohet në DST .
- Kontrata e furnizimit datë 28.05.2019 për mbjellje bari dekorativ dhe FV peme dekorative nuk është lidhur para noterit e si e tille nuk mund te kete efekt juridik ,duke mos përmbushur kështu ky BOE kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.19 të Kriterëve te vecanta te Kualifikimit.
- Nuk përmbush kriterin për një autopompë betoni pasi nga anëtari „Zdravo“shpk është deklaruar ne shtojcen 9 një autopompe betoni me targa AA745AT si dhe dorëzuar dokumentacioni për kete mjet,dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka perfunduar afati i licenses per transport mallrash me date 13.03.2019, para datës së zhvillimit të procedurës.
- Per teknikat e ndertimit nuk eshte dorezuar diploma e shkolles se mesme ne ndertim,per teknik ndertim B.K libreza e punes eshte e paplotesuar ,duke mos permbushur keshtu kriterin e percaktuar ne piken 8 te Kriterëve te vecanta te Kualifikimit.
- BOE-“Viante Konstruksion” shpk & “Fusha “ shpk & Llazo” shpk,për arsyet :
Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky BOE **nuk** ka dorezuar ne SPE dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST,konkretisht:
- Nuk përmbush kriterin për një autobitumatrice pasi Automjeti me targa AA154 GO i deklaruar si autobitumatrice nga anëtari “Fusha” shpk i ka perfunduar data e siguracionit me date 16.05.2019 ,para datës së zhvillimit te procedurës në kundërshtim me pikën 2.3.20/a të Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit
- Nuk përmbush kriterin për dy kamionë me vinc me kapacitet mbajtes 7-13 ton në kundërshtim me pikën 2.3.20 të Kriterëve te vecanta te Kualifikimit,Referuar shtojces 9 „Mbi disponimin e makinerive“ të dorëzuar nga 3 anëtarët e BOE, është deklaruar vetëm nga anëtari „Viante Konstruksion „ shpk një ,autovinc“ i marrë me qera nga „Isobar Construction“ shpk, i cili sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtës nën 7 ton në kundërshtim me pikën 2.3.20/a të Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit .
- Nuk permbush kriterin për një Makineri per vizimin e rrugeve termoplastike, nga dokumentacioni konstatohet se është dorëzuar nga anëtari ”Fusha ” shpk një deklaratë doganore R14550 datë 21.03.2015 për një makineri vijëzimi por pa e specifikuar nëse është termoplastike.
- Shoqëria ”Llazo” shpk si anëtare e BOE nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit nr. 2091 rep,nr.1200 kol/1 datë 29.05.2019 ka marrë përsipër paraqitjen e nje oferte konkurruese në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Kocaj”për kryerjen e punimeve të ndërtimit për këtë objekt ku kjo shoqëri merr përsipër në masën 100 % kryerjen e punimeve që përfshin licensa III.IA Tipi C , dhe sipas kontratës së bashkëpunimit secila palë merr përsipër konfidencialitetin e këtij bashkëpunimi si dhe mosbashkëpunimin me asnje palë të tretë.Ndërkohë shoqëria “Llazo” shpk po në datë 29.05.2019 ka dorëzuar në po të njëjtën procedurë prokurimi kontratë me një tjetër operator ekonomik”Al-Mexwood”shpk pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi,në të cilën “Llazo” shpk bie dakord të ofrojë ambjentet e tij për depozitim e mbetjeve jo të rrezikshme që do të dalin gjatë punimeve që do të kryhen në objektin “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Kocaj”.Gjithashtu shoqëria Llazo” shpk ka lidhur

kontratë qeradhënie mjetesh me shoqërinë “Al-Mexwood” shpk nr.2633 rep . nr.1009 kol datë 29.05.2019 për efekt të tenderit me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Kocaj”. Mjetet sipas kontratës së qerasë janë deklaruar nga shoqëria “Llazo” shpk edhe si pjesë e BOE “Viante Konstruksion” shpk & “Fusha” shpk & “Llazo” shpk .Në të njëjtën datë (dt.29.05.2019) dhe për të njëjtin objekt prokurimi shoqëria “Llazo” shpk ,ka lidhur 3 kontrata bashkëpunimi me operatorë ekonomikë të ndryshëm , dy prej të cilëve kanë dorëzuar oferta më vete(BOE ku bën pjesë dhe ‘Al-Mexwood”shk.Kjo bie në kundërshtim me nenin 74/1 të VKM-së nr .914 datë. 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar, neni 63 “*Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative*” dhe neni 74/1 “*Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesnjëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet*”. Gjithashtu ‘Llazo” shpk ka deklaruar në shtojcën 1/1 “*Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur “ se: nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me: çmimet ; metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm ..*

- Anëtar i “Llazo” shpk ka deklaruar se “7. Deklaroj se personeli inxhiniero-teknik i shoqërisë nuk janë të angazhuar në asnjë marrëdhënie pune tjetër me shtetin apo me ndonjë subjekt tjetër privat si dhe nuk do të jenë të angazhuar në asnjë sipërmarrje tjetër (kontrata të tjera) në momentin e lidhjes së kontratës dhe gjatë periudhës së zbatimit të objektit, në rast shpallje fitues në këtë procedurë tenderimi dhe do të jenë në dispozicion për realizimin e kësaj kontrate gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve deri në kolaudimin e objektit sipas legjislacionit shqiptar”. Nga verifikimet rezulton se disa prej inxhinierëve janë të angazhuara në kontrata të tjera të deklaruara nga ky operator ekonomik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Meteo” sh.p.k, me adresë NJA Pishaj, pasuria 6/76, pranë uzinës, Çekin”, Gramsh, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **39 999 663 (tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, pa TVSH**, pikët totale të marra [____], është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”, Sheshi “Kamber Dërmyshi”, pranë Njesisë së Prokurimit, kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [____], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.06.2019.

Ankesa: Më datë 18.06.2019 regjistrohet në bashki ankesa e OE “Viante Konstruksion” shpk lidhur me vlerësimin e tenderit, në përfundim të shqyrtimit të së cilës AK vendosi të pranojë pjesërisht ankesën, dhe me shkresë nr.3986/2 datë 20.06.2019 njoftohet operatori ekonomik

ankimues.Më datë 02.07.2019 , përfundoi afati i ankimit kundër vendimit të Autoritetit Kontraktor dhe rezultoi se operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk paraqiti ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**KRYETARI
LULJETA DOLLANI**

Konceptoi E.Guzi
Miratoi E.Guzi
Dosja nr _____
Afati _____

